



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

**TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori IV 2018**



## Përmbajtje

I . HYRJE .....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME.....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE .....	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare.....	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar.....	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres .....	9

## I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e katërt të vitit 2018 dhe krahasimet me tremujorin e tretë të vitit 2018 dhe me tremujorin e katërt të vitit 2017, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Shërbim Postar”-“Tregu Postar Statistika”- “Statistika të tregut postar”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e katërt të vitit 2018 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (14 subjekte):**

1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S)
2. Albanian Courier sh.p.k (A.C)
3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx)
4. DHL International (Albania) sh.p.k
5. RAD MAIL sh.p.k
6. Sky Net Logistic sh.p.k
7. TNT Express Albania sh.p.k
8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex)
9. United Transport sh.p.k (Uni Trans)
10. Youth Albania Professional Services (YAPS)
11. Fast-Delivery sh.p.k
12. E-KOMPLET sh.p.k
13. COEX shpk
14. Albanian Parcel Distribution shpk

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018 rezultojnë 6,164,238 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

**Tabela 1.1-** Të dhëna përmbljedhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e katërt 2018 dhe krahasimi me tremujorin e tretë 2018 dhe me tremujorin e katërt 2017.


Shërbime postare të ofruara		T4_2017	T1_2018	T2_2018	T3_2018	T4_2018	Ndryshim T4_2018/ T3_2018	Ndryshim T4_2018/ T4_2017
<b>Posta Shqiptare sh.a</b>								
<b>1</b>	<b>Shërbim Universal Postar</b>							
1.1	Postë brenda vendit	4,553,670	4,398,326	5,057,453	4,596,180	4,246,184	-7.6%	-7%
1.2	Postë ndërkombëtare	422,062	366,173	326,467	486,011	234,923	-51.7%	-44%
<b>1.3</b>	<b>Totali 1.1+1.2</b>	<b>4,975,732</b>	<b>4,764,499</b>	<b>5,383,920</b>	<b>5,082,191</b>	<b>4,481,107</b>	<b>-11.8%</b>	<b>-10%</b>
<b>2</b>	<b>Shërbim joniversal postar</b>							
2.1	Postë brenda vendit	661,202	540,222	589,209	793,573	896,597	13.0%	36%
2.2	Postë ndërkombëtare	1,248	445	300	224	472	110.7%	-62%
2.3	<b>Totali 2.1+2.2</b>	<b>662,450</b>	<b>540,667</b>	<b>589,509</b>	<b>793,797</b>	<b>897,069</b>	<b>13.0%</b>	<b>35%</b>
<b>3</b>	<b>Shërbim ekspres</b>							
3.1	Ekspres brenda vendit	176,312	163,968	170,829	187,313	177,621	-5.2%	1%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	6,191	4,611	5,068	3,729	5,434	45.7%	-12%
3.3	<b>Totali 3.1+3.2</b>	<b>182,503</b>	<b>168,579</b>	<b>175,897</b>	<b>191,042</b>	<b>183,055</b>	<b>-4.2%</b>	<b>0%</b>
<b>Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare</b>								
<b>4</b>	<b>Shërbim JoUniversal Postar</b>							
4.1	Postë brenda vendit	113,894	118,115	124,881	130,202	117,747	-9.6%	3.4%
4.2	Postë ndërkombëtare	9,473	143,846	166,819	9,714	8,653	-10.9%	-8.7%
4.3	<b>Totali 4.1+4.2</b>	<b>123,367</b>	<b>261,961</b>	<b>291,700</b>	<b>139,916</b>	<b>126,400</b>	<b>-9.7%</b>	<b>2.5%</b>
<b>5</b>	<b>Shërbim ekspres</b>							
5.1	Ekspres brenda vendit	303,023	188,075	193,025	377,011	414,844	10.0%	36.9%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	54,721	45,470	52,887	55,381	61,763	11.5%	12.9%
5.3	<b>Totali 5.1+5.2</b>	<b>357,744</b>	<b>233,545</b>	<b>245,912</b>	<b>432,392</b>	<b>476,607</b>	<b>10.2%</b>	<b>33.2%</b>
<b>6</b>	<b>Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>	<b>6,301,796</b>	<b>5,969,251</b>	<b>6,686,938</b>	<b>6,639,338</b>	<b>6,164,238</b>	<b>-7.2%</b>	<b>-2.2%</b>

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T4 2018

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,561,231	90%
<i>Of. e tjerë</i>	603,007	10%
<b>Totali</b>	<b>6,164,238</b>	<b>100%</b>

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e katërt të vitit 2018 Posta Shqiptare zë rreth **90%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **10%**.

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujorë




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e katërt 2018 ka realizuar 5,561,231 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 505,799 objekte postare më pak se tremujori i tretë 2018, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e katërt 2018 kanë realizuar 30,699 objekte postare më shumë se në tremujorin e tretë të vitit 2018.

**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T4-2018

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
4,481,107	1,023,469	659,662	6,164,238
72.7%	16.6%	10.7%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 72.7% ose 4,481,107 objekte postare, ndjekur nga shërbimi jo universal me rreth 16.6% ose 1,023,469 objekte postare. Shërbimi ekspres zë 10.7% ose 659,662 objekte postare.

**Grafiku 1.2** Ecuria në 3-mujorë sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhet në nivelet rreth 73% për tremujorin e katërt të vitit 2018. Nga krahasimi i periudhës T4-2018 me periudhën T3-2018, vërehet një rënie e numrit të shërbimeve postare në masën 475,100 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të katërt të vitit 2018 me tremujorin e katërt të vitit 2017 vërehet një rënie e shërbimeve postare në masën rreth 137,558 shërbime.


## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T4-2018

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,246,184
Postë ndërkombëtare	234,923
<b>Totali</b>	<b>4,481,107</b>

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të katërt 2018, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 4,481,107 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,246,184 ose 95%, dhe Postë ndërkombëtare 234,923 objekte, ose 5%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,543,460 shërbime për objekte të thjeshta dhe 702,724 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 86,694 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 148,229 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujorë



### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
Shërbim universal postar	4,481,107	81%
Shërbim jo universal postar	897,069	16%
Shërbim ekspres	183,055	3%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 4,481,107 objekte postare ose 81%, i ndjekur nga shërbimi jo universal me 897,069 objekte postare ose 16%, dhe shërbimi ekspres me 183,055 objekte postare ose 3%.

**Grafiku 1.4:** Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujorë



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2018 dhe 3-mujorit të fundit të vitit 2017, nga ku vihet re një rritje në numrin e objekteve postare për shërbimin jo universal dhe shërbimin ekspres dhe një rënie e ndjeshme për shërbimin universal e krahasuar kjo me tremujorin e tretë të vitit 2018.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.


**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Sh	897,069	88%
Of. e tjerë	126,400	12%
<b>Totali</b>	<b>1,023,469</b>	<b>100%</b>

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i ka Posta Shqiptare me 897,069 objekte postare ose 88% të tregut, kundrejt ofruesve të tjerë me 126,400 objekte postare ose 12%.



**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujorë



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e katërt 2018 krahasuar me tremujorin e tretë 2018 janë rritur për Postën Shqiptare me 103,272 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë ulur me 13,516 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rritje graduale e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim, ku nga rreth 84 % që zinte në tremujorin e katërt të vitit 2017, pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ka arritur në rreth 88%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018 përbëhej nga 1,014,344 objekte brenda vendit dhe 9,125 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


### 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2018, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2017, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e katërt 2018.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Shqiptare	183,055	28%
Of. e tjerë	476,607	72%
Totali T4-2018	659,662	100%

**Grafik 1.6:** Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria ne 3-mujore



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2017, sikundër vërehet rritje në shërbimet postare ekspres për tremujorin e katërt të vitit 2018 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T3–2018). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për postën Shqiptare, ku nga rreth 34% të tregut për këtë tregues në tremujorin e katërt të vitit 2017, pjesa e tregut të postës shqiptare në tremujorin e katërt të vitit 2018 ka arritur në rreth 28%, përkundrajt rreth 72% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 592,465 objekte postare ose 90%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 67,197 objekte postare ose 10%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 44,993 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 22,204 objekte.